

Përgjegjës në Sektorin e Projekteve, në Drejtorinë e Koordinimit dhe Projekteve, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 753, datë 13.12.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Urdhrit Nr. 67, datë 30.05.2025, Për miratimin e Rregullores “Për Metodën e Brendshme të Punës dhe për Sjelljen e Personelit të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, si dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 4 datë 08.01.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Përgjegjës në Sektorin e Projekteve, në Drejtorinë e Koordinimit dhe Projekteve, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

1. Drejton, organizon dhe koordinon veprimtarinë e sektorit që ka në varësi dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e tij.
2. Përgjegjës për hartimin e projekt-planeve dhe zbatimin e tyre duke ndjekur me rigorozitet etapat, aktivitetet, raportimet dhe monitorimet.
3. Bashkëpunon me strukturat e ASIG për identifikimin e mundësive për projekte të reja si dhe në vijimin e proceseve për realizimin e tyre.
4. Përgjegjës për përcaktimin e indikatorëve lidhur me ndjekjen e realizimit të projekteve.
5. Bashkëpunon me të gjithë sektorët e ASIG në realizimin e detyrave sektoriale.
6. Përgjegjës për kontrollin dhe monitorimin e aktivitetit të përditshëm të sektorit, siguron përmbushjen e detyrave të secilit punojës në veçanti dhe të sektorit në tërësi.
7. Përgjegjës për ndjekjen e realizimit të planeve vjetore të punës së sektorit nëpërmjet indikatorëve monitorues që lidhen me realizimin e implementimit të projekteve të çdo strukture të ASIG.
8. Përgjegjës për korrigjimin e shmangieve që mund të rezultojnë mes objektivave institucionale dhe rezultatit faktik duke sugjeruar masa korrigjuese.
9. Përgjegjës për raportimet mbi realizimin e detyrave të sektorit dhe të aktivitetëve që ndjek në funksion të realizimit të objektivit institucional.
10. Përgjegjës për të koordinuar e bashkërenduar punët mes sektorëve implementues të projekteve dhe kërkesave të institucioneve të tjera për “produktet” e ASIG duke garantuar realizimin në kohë dhe me cilësi të tyre.
11. Shpërndan dhe kontrollon punën e specialistëve të sektorit për përmbushjen e funksioneve të sektorit në kohë dhe me cilësi.
12. Menaxhon bazën e të dhënave dhe çdo informacion tjetër të krijuar apo marrë në dorëzim, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

13. Kontribuon në realizimin e planit vjetor të institucionit dhe arritjen e objektivave në përputhje me fushën e veprimtimit të institucionit e veçanërisht të këtij sektori.
14. Raporton në mënyrë periodike pranë Drejtorit të Drejtorisë së Koordinimit dhe Projekteve duke përgatitur informacion periodik dhe e mban të informuar në vazhdimësi në lidhje me realizimin e implementimit të projekteve të ASIG.
15. Ofron rol teknik me aftësinë për të menaxhuar implementimin e projekteve pasi të identifikohen mjetet e punës të matshme për programe/projekte në proces apo në krijim.
16. Drejton dhe organizon punën për krijimin e kushteve të nevojshme duke mbështetur një shpërndarje më të informuar të burimeve dhe për të ndihmuar zbatimin e prioriteteve organizative.
17. Përfaqëson institucionin në takime punë, bashkëpunim me strukturat e ASIG apo partnerë në aktivitete lidhur me fushën e veprimtarisë që mbulon drejtoria dhe më gjerë.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

1. Të zotërojnë Diplomë “Master Shkencor” në një nga fushat: Shkenca Ekonomike, Menaxhim, Gjeodezi, Gjeoinformatikë, Shkenca të Mjedisit, Teknologji Informacioni, Shkenca Juridike, ose profile të tjera të ngjashme që lidhen me menaxhimin strategjik të projekteve, programet gjeohapësinore dhe/ose administrimin e kontratave dhe marrëdhënieve institucionale.
2. Të ketë jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune në profesion.
3. Të zotërojnë aftësi për analizimin e të dhënave dhe përgatitjen e raporteve profesionale mbi progresin dhe rezultatet e projekteve.
4. Të ketë aftësi të mira komunikimi, monitorimi e negociimi.
5. Të ketë aftësi të mira drejtimi (leadership), komunikimi, negociimi, gjykim e iniciative për tu marrë me probleme komplekse.
6. Të zotërojnë njohuri të gjëra të fushës së marrëdhënieve dhe komunikimit, aftësi për të evidentuar arritjet dhe objektivat institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, aftësi për të vlerësuar opsione zgjidhjesh dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.
7. Të njohë mirë kuadrin ligjor dhe nënligjor që lidhet me Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor dhe kuadrin ligjor të autoriteteve përgjegjëse, sipas nenit 11, të ligjit nr. 72/2012, i ndryshuar, për këtë informacion si dhe legjislacionin e BE që lidhen me gjeoinformacionin (Direktiva INSPIRE).
8. Të njohë mirë gjuhën angleze, edhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.
9. Të njohë programet kompjuterike bazë.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (III-1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 18.12.2025, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë ose në adresën e e-mailit burime.njerezore@asig.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmive të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.